



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/02  
Datë: 12.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 04/20 i datës 20.12.2017.
2. Pagat për pozitat e përcaktuara me vendimin e shfuqizuar nga pika 1, kthehen në lartësinë e përcaktuar me rregullimin juridik të mëparshëm.
3. Ky vendim nuk ka efekt në uljen e pagave aktuale në sistemin e drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese në pajtim me nenin 15 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; nenin 35, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat; nenin 21, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.1 deri në 1.10 të Ligjit Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit; nenin 18, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenin 18, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial.
4. Ky vendim vlen deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese në lidhje me rastin KO219/19 për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik.
5. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 02/59, i datës 17.11.2015, kështu që nga pika 2. e këtij vendimi fshihet teksti: "së plotë që kanë marrë gjatë muajit të fundit të mandatit të tyre", dhe zëvendësohet me tekstin: "aktuale të tyre".
6. Obligohet Thesari i Kosovës në Ministrinë e Financave dhe Transfereve dhe institucionet tjera përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe zbatohet nga data 3 shkurt 2020.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/02  
Datë: 12.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Shfuqizohen Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, si në vijim;
  - 1.1. Vendimi i Qeverisë Nr. 16/36, i datës 16 mars 2018, për emërimin e Koordinatorit Nacional për Reforma Shtetërore;
  - 1.2. Vendimi i Qeverisë Nr. 03/49, i datës 29 maj 2018, për emërimin e Koordinatorit Nacional për Ndryshime Klimatike dhe Çështje të Ambientit;
  - 1.3. Vendimi i Qeverisë Nr. 04/49, i datës 29 maj 2018, për emërimin e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Republikën e Kosovës;
  - 1.4. Vendimi i Qeverisë Nr. 11/57, i datës 17 korrik 2018, për emërimin e udhëheqësit të Projektit për Menaxhimin dhe Kontrollin e Qenve Endacakë;
  - 1.5. Vendimi i Qeverisë Nr. 07/89, i datës 12 shkurt 2019, për emërimin e Koordinatorit Nacional kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Terrorizmit;
  - 1.6. Vendimi i Qeverisë Nr. 03/98, i datës 18 prill 2019, për emërimin e Koordinatorit Nacional për Integrim dhe Anëtarësim në NATO;
  - 1.7. Vendimi i Qeverisë Nr. 02/107, i datës 18 qershor 2019, për themelimin e Task Forcës Kundër Narkotik tek të rinjtë dhe siguri në Shkolla.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/02  
Datë: 12.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 16 paragrafi 2 të Ligjit për Partneritet Publiko-Privat Nr. 04/L-045, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Emërohet Komiteti për Partneritet Publiko-Privat, në këtë përbërje të anëtarëve të përhershëm, ministrat nga dikasteret në vijim:

1.1. Ministria e Financave dhe Transfereve,	Kryesues;
1.2. Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike,	Anëtar;
1.3. Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit,	Anëtar;
1.4. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,	Anëtar;
1.5. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,	Anëtar;
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Transfereve dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 08/13, i datës 10.11.2017, për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Partneritet Publiko Privat.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/02  
Datë: 12.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet rekomandimi i Ministrisë së Financave dhe Transfereve për të kërkuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës zgjatjen e ndarjeve buxhetore edhe për një muaj, sipas nenit 24, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-021.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që të dërgojë këtë vendim në Kuvendin e Kosovës dhe të ndërmarrë procedurat e nevojshme në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për procedim të mëtejshëm nga Kuvendi i Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/02  
Datë: 12.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave dhe Transfereve për negocimin e "Marrëveshjes për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal lidhur me Tatimin në të Hyra dhe Kapital" në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Finlandës.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave dhe Transfereve obligohet të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/02

Datë: 12.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim nisma e Ministrisë së Financave dhe Transfereve për negocimin e "Marrëveshjes për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal lidhur me Tatimin në të Hyra dhe Kapital" në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Holandës.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave dhe Transfereve obligohet të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 07/02

Datë: 12.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 29,809.10 euro për projektin e GIZ-it të cilët i kanë mbështetur refugjatët nga Republika e Shqipërisë gjatë qëndrimit në parkun inovativ të Biznesit në Prizren, me rastin e tërmetit.
2. Mjetet nga pika 1. merren nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve të rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Financave nën programi Thesari me kod 11200 në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere si dhe barten në xhirrolloarinë e GIZ-it me nr. 1110047664000150 ProCredit Bank.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Transfereve për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 08/02  
Datë: 12.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet mbështetja financiare për evitimin e dëmeve nga fatkeqësia natyrore në komunën e Pejës dhe të Istogut. Sipas raportit të komisionit, dëmet arrijnë shumën prej 433,050.00 euro.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232 nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve e rezervës dhe transferohen si vijon:
  - Komunës së Pejës, Programi Arsim dhe Shkencë nënprogrami Administratë 92095 në kategorinë e shpenzimeve Investime kapitale në projektin me kod 44829 "Renovimi i Shkollave Fillore dhe të Mesme" shuma prej 297,050.00 euro;
  - Komunës së Istogut, Programi Arsim dhe Shkencë nënprogrami Administratë 92085 në kategorinë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime në shumë prej 136,000.00 euro.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Transfereve për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/02

Datë: 12.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Grupi punues për koordinimin e aktiviteteve dhe manifestimeve për shënimin e dymbëdhjetë vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, në këtë përbërje:
  - 1.1. Haki Abazi, zëvendëskryeministër i dytë, kryesues;
  - 1.2. Vlora Dumoshi, ministre e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, anëtare;
  - 1.3. Anton Quni, ministër i Mbrojtjes, anëtar;
  - 1.4. Emilija Rexhepi, ministre e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtare;
  
2. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë